

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "FA.GI. COSTRUZIONI ITALIANE" SH. P. K.

Sot, më datën 02/03/2020 Z. Roberto Carrieri, i lindur në Martina Franca (TA), Itali, datë 18 Nentor 1976, mbajtes i dokumentit të identifikimit me numer CA63252FD, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "FA.GI. COSTRUZIONI ITALIANE" Sh. P. K. si më poshtë vijon:

Neni 1

Personi fizikë i sipërpërmendur, me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin "FA.GI. COSTRUZIONI ITALIANE" Sh. P. K.
Ortak i vetëm i shoqërisë është Z. Roberto Carrieri

Administrator i kësaj shoqërie caktohet Z. Roberto Carrieri

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria "FA.GI. COSTRUZIONI ITALIANE" Sh. P. K. gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Sh. P. K.". Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë "FA.GI. COSTRUZIONI ITALIANE" Sh. P. K është **Lagja 04, Rruga "Fetah Billaca" Pallati nr. 1133, zona Kadastrale 8514, Kati i tretë, përballë shkollës "Jusuf Puka" Durres.**

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe të caktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Punime ndertimi

- Konsulence teknike
- Import – export te materialeve te ndertimit dhe te makinerive e paisjeve industriale
- Asistence teknike ne fushen e ndertimit

Neni 5

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera teresisht nga ortaku i vetem:

Z. Roberto Carrieri zoteron nje kuote me vlere 100.000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaku i vetem pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kesaj shoqerie i perket ortakut te saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Roberto Carrieri

